



Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri  
Tel: 00 355 42240978  
[info@ukt.al](mailto:info@ukt.al)  
NIPT L72320033P

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë , më \_\_\_/\_\_\_/ 2018

## FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

**Për:** Operatorin Ekonomik “AKM Albanian Investment” sh.p.k,

**Procedura e prokurimit:** “Kërkesë Për Propozim-Mallra”

**Numri i referencës së procedurës:** REF- 94912-11-20-2018

**Përshkrim i shkurtër i kontratës:** “Blerje Vegla Pune për Oficinën”.

**Fondi Limit:** 1 460 000 (një milion e katërqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë pa tvsh..

**Burimi i financimit:** Të ardhurat e SH.A Ujësjellës-Kanalizime Tiranë.

**Afati për lëvrimin e mallrave:** 2 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.

**Data e zhvillimit të tenderit është:** 03.12.2018 Ora: 09:00

**Buletini i Njoftimeve Publike:** Nr.47 të dates 26/11/2018

**Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:** çmimi më i ulët X

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

- |  |            |
|--|------------|
| 1. “Westec” shpk   | L01621002O |
| Vlera 1.050.000(një milion e pesëdhjetë mijë) lekë pa tvsh                         |            |
| 2. “Muhoplus” shpk   | L52317046G |
| Vlera 0 (zero) leke pa tvsh  |            |
| 3. “AKM Albanian Investment” shpk  | L72230026K |
| Vlera 1.222.400 (një milion e dyqind e njëzetë e dy mijë e katërqind) lekë pa tvsh |            |
| 4. “Trinity Trade Company” shpk  | K81630026U |

Vlera 1.327.000 (një milion e treqind e njëzetë e shtatë mijë) leke pa tvsh

5. **“Ligus” shpk**

L51523001S

Vlera 1.398.500 (një milion e treqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e pesëqind) leke pa tvsh

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. **“Westec” shpk**

L01621002O

Vlera 1.050.000(një milion e pesëdhjetë mijë) lekë pa tvsh

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

**Autoriteti Kontraktor në dokumentat standartë të tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ pika 2 d)si më poshtë cituar:**

*d. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

Për plotësimin e kriterit për shlyerjen e energjisë elektrike, operatori ekonomik “WESTEC”ka paraqitur dokumentacionin e mëposhtëm në portalin elektronik të APP-së për këtë procedurë prokurimi:

*“Vërtetim debie” nr. 8970 prot, date 26.10.2018 lëshuar nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a, në emër të kërkuesit “WESTEC” sh.p.k ku evidentohet që: “... nga verifikimet e kryera në Sistemin e Faturimit, për kontratat me rezultun të ketë në total 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e llogaritur deri në datën 25.10.2018 duke përfshirë faturën koherente të muajit Shtator 2018.*

Referuar Nenit 9 (“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me VKM Nr. 109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”, përcaktohet shprehimisht që: “Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, **jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.**

Vërtetimi i Debisë i paraqitur në sistemin elektronik nga Operatori ekonomik nuk vërteton shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike për periudhën më të fundit para hapjes së ofertave që tashmë ishte maturuar për procedurën e prokurimit konkretisht **muajin Tetor 2018.**

Nisur nga sa më lart, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se Operatori ekonomik “nuk plotëson Kriteret e Veçanta për Kualifikim pika 1 gërma “d” të vendosur në DST, c’ka bie në kundërshtim me VKM-në Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu III, Seksioni II, Neni 26, pika 7 gërma “c” ku ndër të tjera citohet se ”Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rasti kur rezultun se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankiminë gjykatë.”

Gjithashtu vlen të theksojmë se publikimi i procedurës objekt në sistemin elektronik të app-së është bërë në datën 21.11.2018 dhe data e hapjes së ofertave është lënë më datën 03.12.2018 brenda këtij afati operatorët ekonomikë e kishin detyrim të kishin bërë bërë pagesën e faturës së muajit Tetor 2018 si dhe të pajiseshin me vërtetim mbi shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri kjo theksojmë Refruar Nenit 9 (“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me VKM Nr. 109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”, përcaktohet shprehimisht që: “Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar. Në mbështetje të VKM-në Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu III, Seksioni II, Neni 26, pika 7 gërma “c” ku ndër të tjera citohet se ”Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankiminë gjykatë” Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se dokumentacioni i paraqitur për përmbushjen e këtij kriteri është i paplotë për rrjedhojë i pavlefshëm.

***Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.***

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

**Muhoplus” shpk**

L52317046G

Vlera 0 (zero) leke pa tvsh

Më datë 06.12.2018 pranë Autoritetit Kontraktor UKT sh.a është protokolluar shkresa e operatorit ekonomik “Muhoplus Ltd” sh.p.k me lëndë: “Deklaratë tërheqje” prot hyrës 27285, datë 06.12.2018 me anë të së cilën parashtron arsyet e tërheqjes nga procedura objekt prokurimi.

Duke qënë se një situatë e tillë nuk është e rregulluar nga ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave mbështetet në ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” i cili në nenin 94, “Tërheqja e kërkesës apo braktisja e procedurës”, pika 1 parashikon se “Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë.”

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se operatori ekonomik pjesëmarrës është në të drejtën e tij të kërkojë të heqë dorë nga procedura objekt prokurimi dhe për rrjedhojë të mos shqyrtojë dokumentacionin e paraqitur në sistemin elektronik nga operatori ekonomik Muhoplus Ltd sh.p.k.

Heqja dorë nga oferta e paraqitur nga operatori ekonomik për procedurën objekt prokurimi sjell për rrjedhojë përfundimin e procedimit administrativ pa një vendim përfundimtar për çështjen.

Përsa më sipër KVO vendos të skualifikojë operatorin ekonomik “Muhoplus Ltd”sh.p.k.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “**AKM Albanian Investment**”sh.p.k me ofertë 1.222.400 (një milion e dyqind e njëzetë e dy mijë e katërqind) leke pa tvsh. pikët totale të marra [\_\_\_\_\_]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë UKT sh.a sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të vijohet siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **06.12.2018**

**Ankesa:JO**

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**Redi MOLLA**

